



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 4212/11 Prot.

Tiranë, më 24.11 2022

Lënda: Përcillet ftesa për pjesëmarrje në momentin e organizimit të shortit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2023.

Drejtuar: AMBASADËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË TIRANË

Tiranë

I/E nderuar,

Siç edhe mund të jeni në dijeni, Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 221, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, ka vendosur të hedhë shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2023.

Shorti do të zhvillohet ditën e hënë, **datë 5.12.2022, ora 10:00**, në sallën "Skënderbej", në selinë e Institucionit të Presidentit të Republikës, me adresë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1, Tiranë.

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Bajram Begaj, në vijimësi të traditës dhe praktikës së deritanishme, ka vlerësuar që të ftojë nga një përfaqësues të misioneve tuaja të ekspertizës, që mbulojnë çështjet e drejtësisë, për të qenë të pranishëm në momentin e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së.

Lutemi, përcjelljen e të dhënave identifikuese të përfaqësuesit që do të ndjekë hedhjen e shortit, sipas kësaj ftese.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Florian KALI

